

VENDIM
Nr.783, datë 10.11.2011

**PËR PROCEDURAT E NDARJES SË TË ARDHURAVE TË TAKSËS VJETORE
TË MJETEVE TË PËRDORURA ME NJËSITË E QEVERISJES VENDORE**

(Ndryshuar me VKM nr. 923, datë 29.12.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor së bashku me drejtoritë rajonale të shërbimit të transportit rrugor në varësi të saj, të caktuara me ligj si agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, deklarojnë dhe paguajnë taksën brenda datës 15 të muajit pasardhës, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit të Financave.

Për periudhën tatimore dhjetor 2014, deklarimi dhe pagesa e kësaj takse për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore bëhet brenda datës 15 janar 2015.

2. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njërive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin (komunë, bashki) të taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

3. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhen me anë të faturës për arkëtim, 18 (tetëmbëdhjetë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 82 (tetëdhjetë e dy)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj).

4. Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave, si dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha